



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**Përfaqësuesi i Lirisë së Medias**



Strasbourg, më 14 tetor 2004

ATCM(2004)028

## **Analizë dhe Komentë**

**për**

**Projektndryshimet në ligjin nr. 8410, datë 30 shtator 1998,  
për “Radion dhe Televizionin Publik e Privat në  
Republikën e Shqipërisë“, lidhur me futjen e  
transmetimeve numerike tokësore**

**nga**

**Karol Jakubowicz**



## **Analizë dhe Komente**

**për**

**Projektndryshimet në ligjin nr. 8410, datë 30 shtator  
1998, për “Radion dhe Televizionin Publik e Privat në  
Republikën e Shqipërisë“, lidhur me futjen e  
transmetimeve numerike tokësore**

**nga**

**Karol Jakubowicz \***

---

\*Drejtore, Departamenti i Strategjisë dhe Analizës,  
Këshilli Kombëtar i Transmetimeve të Polonisë,  
Zëvendëskryetar, Këshilli Drejtues i MasMedias, Këshilli i Evropës



## **PARATHËNIE**

Rishikimi aktual, i kryer me porosi të përbashkët nga Departamenti i Medias i Këshillit të Evropës dhe Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, ka për synim arritjen e përputhshmërisë së ndryshimeve ekzistuese me standardet evropiane. Duke pasur parasysh se kalimi në transmetimin numerik është një proces madhor ndryshimi në zhvillimin e medias elektronike dhe atë teknologjik në përgjithësi, duhet të merren në konsideratë edhe çështjet kulturore dhe sociale të përfshira në planet e kalimit në transmetimin numerik.

Me “standarde evropiane” do të nënkuptohen kryesisht standardet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës, që rrjedhin nga Neni 10 nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhe trajtohen më tej në një numër konventash, në rekomandimet dhe deklaratat e Komitetit të Ministrave, si edhe në vendimet ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke marrë parasysh negociatat e ardhshme të anëtarësimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian, do të zbatohen edhe disa kritere të BE-së.

## **QËLLIMI**

Ligji Nr. 8410 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat” duket se merr të mirëqenë një situatë statike nga këndvështrimi teknologjik. Duke qenë se dispozitat e tij i referohen teknologjisë tradicionale të transmetimit, është e qartë se ai nuk parashikon një kuadër ligjor për hyrjen e transmetimit numerik tokësor, është e qartë se ndryshimi i tij është i nevojshëm.

Projektndryshimet aktuale kanë për qëllim që ta bëjnë një gjë të tillë dhe, gjithashtu, të përmirësojnë ose plotësojnë disa dispozita të tjera.

## **VLERËSIM I PËRGJITSHËM**

Ndryshimet përbëjnë një pikë të mirë fillimi për krijimin e një kuadri ligjor për transmetimin numerik tokësor. Sidoqoftë, ato nuk arrijnë të rregullojnë shumë aspekte të sistemit (p.sh. sistemet e përdorimit të kushtëzuar, udhëzuesit e programeve elektronike, standardet teknike dhe ndërfunksionimi i pajisjeve, etj.) dhe u lejon forcave të tregut marrjen e shumë vendimeve kyçe (p.sh. përbërja e multiplekseve).

Ndryshimet nuk përmendin shërbimin e transmetimit publik dhe rolin e tij në kalimin tek transmetimi numerik. Kjo është një mungesë serioze dhe duhet të riparohet, së bashku me çështjet e tjera të përmendura në Komentet e Përgjithshme më poshtë.

Në qoftë se kjo nuk bëhet, ligji i ndryshuar do të nxisë një proces kalimi tek një transmetim numerik krejtësisht të drejtuar nga tregu, i cili mund:

- Të jetë i pasuksesshëm dhe jo i plotë, pasi operatorët tregtarë mendojnë se nuk mund të nxirren përfitime të mjaftueshme (pjesërisht për shkak të periudhës së pakufizuar të transmetimit të njëkohshëm, çka nuk sjell një kalim të suksesshëm);
- Të reduktojë perspektivat për arritjen e objektivave të politikës publike në transmetimin numerik.

Një raport i Këshillit të Evropës (Diversiteti i Medias në Evropë. Raport i përgatitur nga Paneli Këshillues i CDMM-së mbi çështjet e përqendrimit, pluralizmit dhe diversitetit të medias) H/APMD (2003) 1. Departamenti i Medias. Drejtorja e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Strasburg, dhjetor 2002) thotë se:

Shumë qeveri evropiane janë të përkushtuara për hyrjen e TTN-së (transmetimi tokësor numerik), kryesisht, për shkak të potencialit të tij demokratik dhe shanset për më shumë larmi. Megjithëse këto vende janë në faza të ndryshme përsa i përket instalimit të kësaj teknologjie të re, pjesa më e madhe e tyre po lëvizin në këtë drejtim. Një nga elementet kryesore që qeveritë e pranojnë si të nevojshëm për vendosjen e DTT-së është një politikë efektive dhe e mirëadministruar e kalimit tek transmetimi numerik.

Ky ligj, ashtu edhe planet e strategjitë e tjera të hartuara në Shqipëri, duhet të orientohen drejt krijimit dhe ekzekutimit të një politike efektive dhe të mirëadministruar të kalimit. Nisur nga ky këndvështrim, këto ndryshime kërkojnë përmirësim dhe shtrirje më të gjerë, ashtu siç sugjerohet më poshtë.

## **KOMENTE TË PËRGJITHSHME**

1.

Rekomandimi (2003) 9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Masat për Nxitjen e Kontributit Demokratik dhe Shoqëror të Transmetimit Numerik, sugjeron që shtetet anëtare:

- a. *të krijojnë kushte të përshtatshme ligjore dhe ekonomike për zhvillimin e transmetimit numerik që të garantojnë pluralizmin e shërbimeve të*

*transmetimit dhe mundësinë që publiku të ketë një gamë të gjerë zgjedhjeje dhe shumëllojshmëri programesh cilësore, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe, aty ku është e mundur, zgjerimin e shërbimeve ndërkufitare të disponueshme;*

- b. të mbrojnë dhe, nëse është e nevojshme, të ndërmarrin masa pozitive për të garantuar dhe nxitur pluralizmin në media, me qëllim që të kompensojnë rritjen e përqendrimit në këtë sektor;*

Ndryshimet aktuale janë një kontribut pozitiv për arritjen e këtyre objektivave. Ato krijojnë një kuadër ligjor bazë për fillimin e kalimit tek transmetimi numerik, të paktën, përsa i përket procedurës së licencimit për rrjetet numerike dhe shërbimet e programeve, dhe i ofrojnë kësaj fushe të re garanci kundër përqendrimit të tepërt të medias.

Sidoqoftë, ndryshimet nuk u japin përgjigje rekomandimeve të tjera kryesore të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës:

- c. për të qenë veçanërisht vigjilentë për të siguruar respekt për mbrojtjen e të vegjëleve dhe dinjitetit njerëzor dhe mosnxitjen e dhunës dhe urrejtjes në mjedisin numerik, i cili ofron një gamë të gjerë në përmbajtje;*
- d. të përgatisin publikun për mjedisin e ri numerik, sidomos duke nxitur ndërtimin e një skeme për informacion të përshtatshëm dhe trajnim në përdorimin e pajisjeve numerike dhe shërbimeve të reja;*
- e. të garantojnë se shërbimi i transmetimit publik, si një faktor thelbësor për kohezionin e shoqërive demokratike, do të mbahet në mjedisin e ri numerik, duke u siguruar individëve të drejtën universale për të përfutur programet e transmetuesve të shërbimit publik dhe duke i dhënë atij, ndër të tjera, një rol qendror në kalimin tek transmetimi numerik tokësor;*
- f. të riafirmojnë misionin e shërbimit të transmetimit publik, duke përshtatur, nëse është nevoja, mjetet e tij në mjedisin e ri numerik, në përputhje me parimet bazë të përcaktuara në tekstet e mëparshme të Këshillit të Evropës, ndërkohë që krijojnë kushtet financiare, teknike e të tjera që do të bëjnë të mundur që ai ta përmbushë këtë mision sa më mirë të jetë e mundur.*

2.

Rekomandimi thotë, gjithashtu, se:

- 4. Kur të nxirren licencat e transmetimit numerik, autoritetet publike*

*përkatëse duhet të sigurohen se shërbimet që ofrohen janë të shumta dhe të shumëllojshme dhe nxisin krijimin e shërbimeve rajonale/vendore për të përmbushur pritshmëritë e publikut në këto nivele.*

Ndryshimet krijojnë një kategori të re të licencave rajonale dhe stacioneve (të cilat mungojnë në ligj) dhe parashikojnë që licensat t'u jepen gjithashtu shërbimeve lokale të programeve numerike. Në këtë kuptim, ndryshimet janë në zbatim të rekomandimeve të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

3.

Në të njëjtën kohë, ndryshimet nuk trajtojnë shumë çështje që kanë nevojë të rregullohen, në mënyrë që të sigurojnë një proces të suksesshëm kalimi. Ato janë renditur pjesërisht në Shtojcën e Rekomandimit (2003) 9 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Masat për Nxitjen e Kontributit Demokratik dhe Shoqëror të Transmetimit Numerik:

- 1. Me qëllim që t'i sigurojnë publikut një gamë të gjerë programesh, shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa që synojnë një nivel të lartë ndërfunksionimi dhe përputhjeje të pajisjes marrëse, deshifruese dhe çkoduese dhe të sistemeve që sigurojnë përdorimin e shërbimeve të transmetimit numerik dhe shërbime të tjera përkatëse interaktive.*
- 2. Me synimin për të afruar datën e kalimit në transmetimin numerik, shtetet anëtare duhet të lehtësojnë kalimin e publikut në transmetimin numerik. Për shembull, ato mund të nxisin industrinë për t'i ofruar publikut një sërë pajisjesh deshifruese, përfshi një aparat deshifruese bazë, që mundëson përfitim të një game minimale shërbimesh.*
- 3. Masa specifike duhet të ndërmerren për të rritur mundësitë e personave me aftësi të kufizuar dëgjimi dhe shikimi që të përfitojnë nga marrja e shërbimeve të transmetimit numerik dhe përmbajtja përkatëse.*
- 4. Në mënyrë që të ndihmojnë publikun të gjejë veten në mjedisin e ri numerik, shtetet anëtare duhet të nxisin transmetuesit që të japin informacion për shërbimet e tyre për udhëzuesit elektronikë të programeve (EPG), si edhe të nxisin prodhuesit e dekoduesve numerikë për të përfshirë funksione që lejojnë informimin në lidhje me programet dhe shërbimet, me qëllim që teleshikuesve t'u jepet informacioni bazë për të cilin ata kanë nevojë për të bërë një zgjedhje të informuar mes shumëllojshmërisë së programeve, kanaleve dhe shërbimeve që iu ofrohen nëpërmjet platformave numerike.*
- 5. Duke mos paragjykuar EPG-të plotësuese që jepen nga transmetuesit për të paraqitur ofertën e programit të tyre, ata që ofrojnë EPG-të duhet t'iu propozojnë të gjithë siguruesve të shërbimit, të cilët e kërkojnë një gjë të tillë*



*në bazë të kushteve të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, një pozicion në EPG-të me të cilat veprojnë. Sidoqoftë, kanalet publike duhet të shfaqen në mënyrë të dukshme dhe të jenë të lehta për t'u përdorur. Ata që hartojnë EPG-të duhet të ofrojnë, gjithashtu, një klasifikim të qartë të shërbimeve programore, sipas subjektit, gjinisë, përmbajtjes e kështu me radhë.*

6. *EPG-të dhe deshifruarit numerikë duhet të krijohen në një mënyrë të tillë që të përdoren me lehtësi nga konsumatori, që do të thotë t'i lejojë ata të vendosin për listën e programeve dhe shërbimeve, sipas preferencave të tyre. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuara ose personave të cilët nuk dinë gjuhë të huaja. Përdorimi i EPG-ve si mjet reklamues nuk duhet të paragjykojë as funksionalitetin e tyre, as integritetin e programeve.*

Ndryshimet përfshijnë disa rregullime të multiplekseve, por nuk përmendin asnjëherë sistemet e kushtëzuara të përdorimit dhe udhëzuesit elektronikë të programeve. Kjo do të thotë se aspekte të rëndësishme të sistemit të transmetimit tokësor numerik janë tërësisht të parregulluara.

4.

Strategjia e kalimit në transmetimin numerik duhet të pranojë rolin e veçantë dhe nevojat e transmetimit publik në këtë proces. Kjo vihet në dukje në Shtojcën e Rekomandimit (2003) 9 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Masat për Nxitjen e Kontributit Demokratik e Shoqëror të Transmetimit Numerik.

*a. Misioni i transmetimit publik*

*19. I përballur me sfidat që shoqërojnë futjen e teknologjive numerike, transmetimi publik duhet të ruajë misionin e tij të posaçëm shoqëror, duke përfshirë një shërbim të përgjithshëm bazë, që ofron programe informative, arsimore, kulturore dhe argëtuese, të cilat iu drejtohen kategorive të ndryshme të publikut. Shtetet anëtare duhet të krijojnë kushtet e duhura financiare, teknike dhe kushte të tjera të nevojshme për t'iu dhënë mundësinë transmetuesve publikë që ta përmbushin sa më mirë që të jetë e mundur këtë mision, ndërkohë që i përshtaten mjedisit të ri numerik. Në këtë kontekst, mjetet për të përmbushur detyrën e transmetimit publik mund të përfshijnë hapjen e kanaleve të reja të specializuara, si për shembull, në fushën e informacionit, arsimit dhe kulturës, dhe krijimin e shërbimeve të reja interaktive, si për shembull EPG-të dhe shërbime interneti që kanë lidhje me programet. Transmetuesit publikë duhet të luajnë një rol qendror në procesin e kalimit në transmetimin numerik tokësor.*

b. Përdorimi universal i transmetimit publik

20. Universalizimi është thelbësor për zhvillimin e transmetimit publik në epokën numerike. Si rrjedhim, shtetet anëtare duhet të sigurojnë krijimin e kushteve ligjore, ekonomike dhe teknike, për t'iu bërë të mundur transmetuesve publikë që të jenë të pranishëm në platformat e ndryshme numerike (kabllore, satelitore, tokësore), nëpërmjet programeve dhe shërbimeve të ndryshme cilësore që janë në gjendje të bashkojnë shoqërinë, veçanërisht duke pasur parasysh rrezikun e fragmentarizimit të shikuesve si rezultat i shumëllojshmërisë dhe specializimit të programeve që ofrohen.

21. Në lidhje me këtë, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e platformave numerike, duhet të zbatohet rregulli i përfshirjes së detyrueshme në favor të transmetuesve publikë, në mënyrën më të arsyeshme që është e mundur, me qëllim që të garantohet përdorimi i shërbimeve dhe programeve nëpërmjet këtyre platformave.

c. Financimi i transmetuesve publikë

22. Brenda kontekstit të ri teknologjik, pa një kuadër financiar të përshtatshëm dhe të sigurt, mbulimi i transmetuesve publikë dhe shkalla e kontributit të tyre në shoqëri mund të zvogëlohet. Të përballur me rritjen e kostos së blerjes, prodhimit dhe ruajtjes së programeve, dhe ndonjëherë edhe me atë të transmetimit, shtetet anëtare duhet t'u japin transmetuesve publikë mundësinë për të siguruar mjetet e nevojshme financiare për të përmubushur misionin e tyre.

Të gjitha këto çështje (dhe veçanërisht rregullat e përfshirjes së detyrueshme për shërbimet e transmetuesve publikë (TP), shtrirja e misionit të TP-së drejt teknologjive të reja dhe financimit të përshtatshëm, me qëllim mbulimin si të kostos së administrimit ashtu edhe të kostove shtesë që kërkon procesi i transformimit në numerik), duhet të trajtohen në këto ndryshime.

**KOMENTE TË HOLLËSISHME**

Asnjë koment nuk është bërë në lidhje me nenet që nuk ngrejnë çështje që kërkojnë diskutim të mëtejshëm.

**Neni 1**

Ky nen ndryshon Nenin 3 duke hequr dy fraza:

Se “veprimtaria radiotelevizive” kryhet në përputhje me “me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”,

Dhe se “Me qëllim ushtrimin e një veprimtarie radiotelevizive private, mund t’i jepet licensë cdo subjekti fizik ose juridik”.

Heqja e frazës së dytë është në përputhje me ndryshimet në sistemin e licensimit në Nenin 19, që do të diskutohet më poshtë. Sidoqoftë, heqja e referimit ndaj akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë është më e vështirë për t’u kuptuar. Në fund të fundit, Neni 5 i Kushtetutës së Shqipërisë deklaron se *“Republika e Shqipërisë zbaton ligjin ndërkombëtar që është detyrues për të”*. Ndoshta, arsyeja është se Neni 3 përmend gjithashtu *”dispozita të tjera ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë”* dhe – duke iu referuar Nenit 5 të Kushtetutës – mund të thuhet se kjo mbulon edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Sidoqoftë, kjo frazë ishte e përfshirë gjithashtu në Nenin 3 në ligjin ekzistues, së bashku me përmendjen e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

Me qëllim parandalimin e ndonjë keqkuptimi, ky referim ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare të detyruese për Shqipërinë duhet të ripërfshihet.

## **Neni 2**

Ky nen shton transmetuesit rajonalë në listën e transmetuesve, programet informative të të cilëve monitorohen nga KKRT-ja. Kjo është në përputhje me shtimin e një kategorie transmetuesish rajonalë në Nenin 19, përkrah transmetuesve kombëtarë dhe lokalë.

## **Neni 3**

Ndryshimi kryesor që i është bërë Nenit 10 nga ky ndryshim ka të bëjë me zëvendësimin e fjalisë vijuese *“Struktura organizative e administratës së KKRT-së përfshin departmente dhe drejtori”* me këtë tekst *“Nëpunësit e administratës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit janë pjesë e shërbimit civil të Republikës së Shqipërisë. Administrimi i shërbimit civil, si edhe rregullimi i marrëdhënieve juridike në fuqi mes nëpunësve civilë dhe KKRT-së rregullohen sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 ‘Statusi i Nëpunësit Civil’”*.

Më pas neni vazhdon, siç ishte, *“Drejtimi i administratës, kualifikimet për punësim, dhe strukturat e rrogës do të përcaktohen të gjitha nga KKRT-ja, në përputhje me çdo model të tillë, ashtu siç mund të jetë vendosur për të tjera institucione të pavarura të ngjashme”*.

Megjithëse sipas Nenit 8, KKRT-ja duhet të “veprojë në mënyrë të pavarur”, pavarësia e saj e vërtetë lë shumë për të dyshuar<sup>1</sup>. Përsëritja e fjalës në Nenin 10 nuk e ndryshon këtë situatë, duke shtuar, për më tepër, se të gjithë nëpunësve të KKRT-së do t’u jepet tashmë statusi i nëpunësit civil, duke i bërë ata potencialisht më shumë të varur nga qeveria.

**Në ligj duhet të shtohen garanci më të efektshme për pavarësinë e KKRT-së, ashtu si kërkohet në Rekomandimin (2000) 23 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Pavarësinë dhe Funkcionet e Autoriteteve Rregulluese për Sektorin e Transmetimit.**

#### **Neni 4**

Neni 11 ndryshohet nëpërmjet shtimit së dispozitës vijuese: *“Tarifat vjetore për licencat për transmetimin e programeve do të jenë respektivisht në sasinë 50% të tarifave për transmetimet radiotelevizive numerike”*.

Ky ndryshim paraqet, si rrjedhim, një tarifë të re që duhet të paguhet nga media elektronike.

**Duhet të tregohet kujdes për të mos i mbingarkuar transmetuesit me detyrime financiare, që do t’i privonte ata nga fondet e nevojshme për t’i ofruar publikut programe gjithëpërfshirëse të cilësisë së lartë.**

#### **Neni 5**

Ky nen ndryshon Nenin 19 në mënyrë që të përfshijë “licencat për krijimin dhe përdorimin e rrjeteve radiotelevizive” (në vend të licensave të transmetimit, siç ishte) dhe duke e ndryshuar fjalinë parë, si vijon: *“Licencat për transmetimin radioteleviziv (licensë rrjeti) shërbejnë si leje për instalimin e pajisjeve teknike dhe për krijimin dhe mbajtjen e një rrjeti (analog ose numerik)”*.

**Duhet të theksohet se kjo nuk përputhet me regjimin e përgjithshëm të autorizimit<sup>2</sup> për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të infrastrukturës elektronike, e parashikuar në Direktivën 2002/20/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës, e datës 7 mars 2002, për autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të infrastrukturës elektronike (Direktiva e Autorizimit).**

Neni 3.2 i Direktivës thotë: *“Ofrimi i rrjeteve të infrastrukturës elektronike ose ofrimi i shërbimeve të infrastrukturës elektronike mund të jetë, pa paragjykime ndaj detyrimeve specifike të përmendura në Nenin 6(2) ose të drejtave të përdorimit të përmendura në Nenin 5, subjekt vetëm i një autorizimi të përgjithshëm. Sipërmarrjes së interesuar mund t’i kërkohet të dorëzojë një njoftim, por nuk mund t’i kërkohet të marrë një vendim të qartë ose ndonjë akt tjetër asministrativ nga autoriteti rregullues kombëtar përpara ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga autorizimi. Kur kërkohet, një sipërmarrje mund të*

*fillojë veprimtarinë, duke dhënë njoftimin, aty ku është e nevojshme, si subjekt i dispozitave për të drejtat e përdorimit në Nenet 5, 6, 7”.*

**Kjo do të thotë se Neni 19, nëse ndryshohet siç është propozuar këtu, do konsiderohet si shkelje e dispozitave të Direktivës.**

Çështja do të qëndronte ndryshe, nëse “licensa” e përmendur në këtë nen do të nënkuptonte vendimin për të dhënë në përdorim një frekuence ose frekuenca dhe/ose të drejtën për instalimin e pajisjeve. Sigurisht që këtu kërkohet një vendim i autoritetit të përshtatshëm, por dhënia e një shërbimi me përdorim të frekuencës ose pajisjeve nuk mund të licensohet sipas ligjit të BE-së.

## **Neni 6**

Propozohet shtimi i Nenet 19/1, për të trajtuar licencat e transmetimit (ofrimi i një shërbimi tematik).

Dy aspekte të kësaj dispozite meritojnë vëmendje.

1.

Ajo përcakton dy metoda të licensimit të shërbimeve programore: çdo shërbim programi në veçanti, ose të gjithë paketën e shërbimeve (ndoshta, kjo mund t’u referohet të gjitha shërbimeve të ofruara në një multipleks) së bashku.

Kjo çështje duhet të konsiderohet në një kontekst më të gjerë, duke përfshirë, gjithashtu, rolin e parashikuar të programuesit të paketës (p.sh. operatori i multipleksit). Ky rol mund të jetë aktiv ose pasiv, në varësi të zgjidhjeve ligjore dhe administrative të miratuara. Në rastin e parë, është organi rregullues ai që përcakton përbërjen e paketës (p.sh. me qëllim që të sigurojë plotësimin e kriteve të tilla si liria e shprehjes, mundësia e përdorimit, pluralizmi, larmia kulturore etj). Në rastin e dytë, është programuesi i paketës që përcakton përbërjen e saj - dhe më pas merr një licensë për këtë paketë. Ndërkohë që zbatohen metoda të ndryshme, metoda e parë është më e përhapur, duke i dhënë autoritetit rregullues më shumë mundësi për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës publike në transmetimin numerik. Për më tepër, metoda e licensimit të të gjithë paketës krijon nevojën e ndryshimit të licensës për të gjithë paketën kur një shërbim programor hiqet nga paketa për një arsye çfarëdo.

**Në ndryshimin e propozuar, zgjedhja mes dy trajtimeve duket se është e hapur, duke e lënë çështjen në gjykimin e autoritetit rregullues. Kjo i privon operatorët e tregut nga siguria ligjore dhe bën të mundur që autoriteti rregullues të zgjedhë secilën prej metodave, siç e shikon më të përshtatshme. Një gjë e tillë duhet të shmangët dhe do të ishte më e preferueshme zgjedhja e metodës së licensimit të secilit prej programeve.**

2.

Ndryshimi i propozuar deklaron: “Operatorët e rrjetit kanë të drejtën të marrin një licensë për transmetimin e programeve radiotelevizive dhe anasjelltas”.

Sërish, kuptimi i termit “licensë” nuk është i qartë. Ashtu sic theksohet në pikën 20 të parathënies së Direktivës së Autorizimit, “*E njëjta sipërmarrje, për shembull një operator kabllor, mund të ofrojë shërbime të infrastrukturës elektronike, si transmetimi i sinjalit televiziv, ashtu edhe shërbimet që nuk mbulojnë nga kjo Direktivë, si tregtimi i një oferte zëri ose shërbime transmetimi të programeve televizive*“. Në këtë rast, operatori i rrjetit është në të njëjtën kohë edhe programuesi i paketës, duke i ofruar publikut shërbime programore që i dërgohen atij nga transmetuesi fillestar, d.m.th. personi fizik ose juridik i cil zotëron një licensë transmetimi.

**Megjithatë, nëse neni nënkupton se operator i rrjetit mund të jetë gjithashtu një transmetues në këtë kuptim, atëherë ai duhet shikohet me shumë kujdes. Është e vërtetë se shkrirja e funksionit të operatorit teknik me atë të ofruesit e programeve është diçka që ndodh shpesh aktualisht në mbarë Evropën. Sidoqoftë, operatorët e rrjetit duhet t’ua ofrojnë shërbimet e tyre transmetuesve mbi baza korrekte dhe jodiskriminuese. Operatorët e rrjetit, të cilët janë në të njëjtën kohë edhe transmetues, gjenden, sigurisht, në konkurrencë me transmetuesit e tjerë. Si rrjedhim, ata mund të mos jenë as korrekte e as jodiskriminues në zgjedhjen e shërbimeve programore që do të shpërndajnë në rrjetin e tyre, në rast se këto shërbime janë në konkurrencë me ofertën e tyre të programeve. Me pak fjalë, nëse një operatori rrjeti i jepet rasti të jetë, gjithashtu, edhe transmetues, kjo do të sillte një konflikt të mundshëm interesash.**

Në variantet e propozuara të neneve 19/3, 23 dhe 35 krijohen disa garanci kundër abuzimit me pozicionin e operatorit të rrjetit, por çështja ka nevojë për trajtim të mëtejshëm.

## **Nenet 8 dhe 9**

### **Neni 8**

Neni 20, i cili merret me “Dispozitat e përgjithshme të licensimit”, trajton tashmë “Dispozitat e përgjithshme të licensimit për hapjen dhe shfrytëzimin e rrjeteve radiofonike ose televizive”. Ndërsa më parë ai trajtonte vetëm transmetuesit, tashmë ai përfshin si transmetuesit, ashtu edhe operatorët e rrjetit. **Kjo mund të krijojë paqartësi dhe mbivendosje me nenin e ri 20/1, që merret vetëm me transmetuesit.**

Përsa u përket operatorëve të rrjeteve kombëtare, rajonale dhe lokale, neni i ndryshuar specifikon kërkesat në lidhje me ta, si vijon:

### **Kërkesat për operatorët e rrjeteve kombëtare, rajonale dhe lokale**

	<b>Kombëtare</b>	<b>Rajonale</b>	<b>Lokale</b>
Forma ligjore	Shoqëri aksionere, aksione nominale, e vendosur në Shqipëri, qëllimi i vetëm: veprimtari transmetuese	Persona juridikë të regjistruar në Shqipëri, qëllimi i vetëm:veprimtari transmetuese	Persona juridikë të regjistruar në Shqipëri, qëllimi i vetëm:veprimtari në transmetuese
Llojet e licensave	-	-	Për një qark dhe për një prefekturë
Mbulimi territorial	70% në 3 vjet, 90% në 6 vjet	1/3 e territorit të vendit, mbulim me 70% i kësaj zone në 2 vjet	Mbulim me 70% i zonës respektive në 2 vjet.
Kufizime mbi zotërimin e aksioneve	40 % e kapitalit	1 person: jo më shumë se 1 licensë	
Kufizimet mbi përqendrimin e medias (1)	1 person: jo më shumë se 20% të licensave për rrjetet kombëtare	1 person: vetëm një licensë për rrjetin rajonal	
Kufizimet mbi përqendrimin e medias (2)			Operatorët lokalë: 1/3 e numrit të frekuencave të vlefshme në një pikë

Më tej, neni i ndryshuar përmban masat anti-përqëndrim si vijon:

Takimet e rregullta dhe të posaçme të aksionerëve të një shoqërie aksionere, qëllimi i vetëm i së cilës është kryerja e veprimtarive transmetuese radiotelevizive, do të njihen vetëm nëse jo më pak se dy e tretat e aksionerëve janë të pranishëm.

Çdo person fizik ose juridik që zotëron aksione në një kompanie kombëtare radioje ose televizioni nuk do të lejohet të ketë aksione, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në një kompani të dytë kombëtare radioje ose televizioni; këtij personi nuk do t'i jepet as licensë transmetimi për radio ose televizion lokal.

Një personi, i cili ka marrë një licensë transmetimi për televizion lokal, mund t'i jepet vetëm një licensë e dytë transmetimi për radio lokale.

Një personi, i cili ka marrë një licensë transmetimi për radio lokale, mund t'i jepet vetëm një licensë e dytë transmetimi për televizion lokal.

Çdo personi juridik, vendas ose të huaj, i cili ka aplikuar për një licensë transmetimi për radio apo televizion, i ndalohet të përdorë një emër tjetër në çdo mënyrë.

### Neni 9

Duhet të shtohet një Neni i ri 20/1, që trajton “Dispozitat e përgjithshme të licensimit për transmetimin e programeve radiofonike ose televizive”.

Ai parashikon dy tipe licensash për transmetimin e programeve radiofonike ose televizive: për një shërbim programor dhe për një paketë shërbimesh programore.

Përsa u përket transmetuesve të shërbimeve programore kombëtare, rajonale dhe lokale, neni i ndryshuar specifikon kërkesat që kanë të bëjnë me ta, si vijon:

#### Për operatorët e transmetuesve kombëtarë, rajonalë dhe lokalë

	<b>Kombëtare</b>	<b>Rajonale</b>	<b>Lokale</b>
Forma ligjore	Shoqëri aksionere, aksione nominale, e vendosur në Shqipëri, qëllimi i vetëm: veprimtari transmetuese	Persona juridikë të regjistruar në Shqipëri, qëllimi i vetëm: veprimtari transmetuese	Persona juridikë të regjistruar në Shqipëri, qëllimi i vetëm: veprimtari transmetuese
Llojet e licensave	-	-	Për një qark dhe për një prefekturë
Mbulimi territorial	-	1/3 e territorit	-
Kufizime mbi pronësinë	1 person: jo më shumë se 40% e aksioneve në një kompani transmetimesh		
Kufizimet mbi përqendrimin e medias (1)	1 person: jo më shumë se 20% e të gjitha licensave të transmetimit		
Kufizimet mbi përqendrimin e medias (2)	1 person: asnjë aksion në një kompani të dytë kombëtare radioje ose televizioni	1 person: jo më shumë se 20% e licensave rajonale	1 person: jo më shumë sesa 1 licensë për radio lokale dhe 1 për televizion lokal
Kufizimet mbi përqendrimin e medias (3)			Operatorët lokalë: 1/3 e numrit të frekuencave të vlefshme në një pikë

Më tej, Neni 20/1 parashtron kërkesat e mëposhtme:

- Takimet e rregullta dhe të posaçme të aksionerëve të një shoqërie aksionare, qëllimi i vetëm i së cilës është kryerja e veprimtarive radiotelevizive, duhet të njihen vetëm nëse jo më pak se dy të tretat e aksionerëve janë të pranishëm.



- Çdo person juridik, vendas ose i huaj, i cili ka aplikuar për një licensë transmetimi për radio ose televizion, ndalohet të përdorë emër tjetër në çdo mënyrë.

Nëse nuk ka një gabim në përkthim, është e qartë se ndarja e dispozitave në lidhje me operatorët e rrjetit (Neni 20) dhe transmetuesve (Neni 20/1) nuk është e plotë. Neni 20 përmban ende kërkesa anti-përqendrim që përfshijnë transmetuesit. Më pas ato përsëriten, ose shtohen të reja në Nenin 20/1. Kjo mbivendosje duhet të eliminohet. Neni 20 duhet të merret vetëm me operatorët e rrjetit, ndërsa Neni 20/1 duhet të merret vetëm me transmetuesit.

Komenteve që i përkasin Nenit 6 në lidhje me dy llojet e licensave të transmetimit (për çdo shërbim programor në veçanti, ose për një paketë programesh), janë të vlefshme edhe për Nenin 9.

## Neni 10

Duhet të shtohet neni 20/2, që do të trajtojë masat kalimtare gjatë periudhës së kalimit në transmetimin numerik dhe gjatë procedurës së përfundimit të analogut (ATO).

Me masat kalimtare nënkuptohet një periudhë transmetimi të njëkohshëm, me të njëjtat kompani që ofrojnë si shërbimet analoge ashtu edhe ato numerike, për një periudhë të pacaktuar kohe. Neni i propozuar parashtron procedurën për marrjen e licensave të dyta numerike për këtë qëllim.

Data e ATO-s duhet të përcaktohet në mënyrë të veçantë, me ligj. Deri tani, nuk është përcaktuar me hollësi asnjë kriter për vendosjen e kësaj date.

Dispozitat e këtij neni janë të një rëndësie kyçe për suksesin e kalimit në transmetimin numerik. Transmetimi i njëkohshëm i programeve të njëjta si në analog, ashtu edhe në numerik, sjell një rritje të kostos që duhet të përballohet nga transmetuesit. Në të njëjtën kohë, ai shpërdoron frekuenca shtesë në mënyrë jorezultative. Më tej, publiku nuk është i motivuar për të investuar në marrjen e pajisjeve çkoduese (set-top-boxes), duke qenë se mund të vazhdojë të marrë të njëjtat shërbime programore nëpërmjet transmetimit analog dhe televizorit. Kjo mund të sjellë shkurajimin e atyre që duan të reklamojnë për të blerë hapësirë publicitare në kanalet e reja numerike, pasi këto të fundit mund të mos thithin një numër të lartë shikuesish.

Kjo ka qenë përvoja e disa vendeve, të cilat kanë ndjekur të njëjtën strategji kalimi. Më tej, një periudhë e gjatë e transmetimit të njëkohshëm, ku iu lihet në dorë transmetuesve nëse duan të aplikojnë për një licensë numerike ose jo, mund të nënkuptojë se kalimi te numeriku mund të kërkojë kohë të gjatë për të arritur në një masë të madhe. Metoda “ishull” e përdorur nga disa vende, ku kalimi i plotë te numeriku vazhdon rajon pas rajoni, ndihmon në shmangien e këtyre rreziqeve, por,

kërkon, në të njëjtën kohë, një proces kalimi shumë të disiplinuar, me afate veprimi të qarta nga të gjithë aktorët.

Duhet të bëhet një zgjedhje e menduar mirë për metodën e kalimit. Si rrjedhim, miratimi i këtij ligji duhet domosdoshmërisht të shoqërohet me miratimin e një strategjie kombëtare të kalimit në transmetimin numerik me qëllim për të siguruar një kalim të suksesshëm.

Kjo duhet të jetë në përputhje me Rekomandimin (2003) 9 të Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare për masat për Nxitjen e Kontributit Demokratik e Shoqëror të Transmetimit Numerik, që thotë pjesërisht:

- 1. Duke qenë se, nga një këndvështrim teknologjik, zhvillimi i transmetimit numerik është i pashmangshëm, do të përbënte një përparësi nëse, përpara se të procedohej me kalimit të mjedisi numerik, shtetet anëtare, në këshillim me industri të ndryshme të përfshira dhe publikun, do të ndërtonin një strategji të mirëpërcaktuar, që do të siguronte një kalim të menduar mirë, i cili do të rriste në maksimum të mirat e tij dhe të ulte në minimum efektet e mundshme negative.*
- 2. Një strategji e tillë, e cila është vecanërisht e nevojshme për televizionet numerike tokësore, duhet të kërkojë nxitjen e bashkëpunimit mes operatorëve, kombinim mes platformave, ndërveprim të deshifruësve, disponueshmërinë e një game të gjerë përmbajtjeje, përfshi shërbime të lira të transmetimit radioteleviziv, dhe shfrytëzimin sa më të gjerë të mundshëm të shanseve unike që mund të ofrojë teknologjia numerike me riorganizimin e frekuencave.*

Strategjia shqiptare duhet ta drejtojë procesin në një mënyrë të tillë që të gjithë aktorët (transmetuesit, operatorë e rrjetit, prodhuesit e furnizuesit e aparateve çkoduese dhe marrësve, gjithashtu edhe ata të pajisjeve të prodhimit dhe transmetimit, publiku, etj.) të kuptojnë procesin dhe afatet për zbatimin e tij, të dinë se si të përshtaten me faza të veçanta të këtij procesi, dhe të jenë të motivuar të sigurojnë përpjekjet dhe shpenzimet e nevojshme në çdo fazë.

Në të kundërt, ekziston një rrezik real që procesi i kalimit të tejzgjatet, madje edhe të rezultojë i pasuksesshëm, në një situatë ku vetëm disa transmetues dhe një pjesë e publikut të kalojnë te numeriku dhe pjesa tjetër të mbetet në mjedisin analog për një të ardhme të afërt.

Edhe kriteret e ATO-s (përfshi depërtimin e transmetimit numerik, nivelin e marrjes së tij, përballueshmërinë e set-top-bokseve etj.) duhet të njoftohen paraprakisht. Nëse një gjë e tillë bëhet nga ky ligj, nuk do të jetë nevoja për të miratuar një ligj të veçantë që merret vetëm me ATO-n. Data mund të përcaktohet nga KKRT-ja, në këshillim me qeverinë.

## Nenet 11 dhe 12

Këto nene parashikojnë ndryshimin e Nenit 23 dhe shtimin e Nenit 23/1, me qëllim rregullimin e procedurave të aplikimit për licenca për hapjen dhe shfrytëzimin e rrjeteve transmetuese radiotelevizive nga njëra anë, dhe për transmetimin nga ana tjetër.

Neni 23 parashikon se aplikuesi mund të përcaktojë me hollësi raportin mes kanaleve që do të përdoren nga zotëruesi i licensës për krijimin dhe shfrytëzimin e rrjeteve (nëse ai ka për qëllim të aplikojë për një licensë transmetimi për programe) dhe kanaleve që janë të disponueshme për palët e treta të licensuara për transmetimin e programeve. Kjo është e rëndësishme në kontekstin e vërejtjeve të bëra në lidhje me Nenin 6 të ndryshimeve (shiko më sipër).

Neni 12 krijon një Nen të ri 23/1, duke shtuar kushtet që vijnë për përmbajtjen e kërkesës për licensë:

1. territorin që do të mbulojë [shërbimi programor];
2. strukturën e çdo programi ose pakete programesh, vendin që do të zënë në këtë strukturë informacioni, arti, kultura, argëtimi, sportet, programet për fëmijë, përmbajtja e disa programeve kryesore dhe programi i përjavshëm;
3. raportin mes kohës së transmetimit të programeve të prodhuara dhe të blera, të dhuruara ose të shkëmbyera;
4. angazhimin për respektimin e parimit të paanshmërisë, gjithëpërfshirjes dhe pluralizmit të informacionit;
5. angazhimin për respektimin e të drejtave të njeriut, në përgjithësi, dhe të të drejtave të fëmijëve e të adoleshentëve, në veçanti, si edhe angazhimi për mostransmetimin e programeve të ndaluara me ligj;
6. angazhimin për të përdorur dhe ruajtur gjuhën shqipe në të gjitha programet që do të transmetohen;
7. angazhimin për respektimin e kërkesave të ligjit në transmetimin e reklamave dhe mesazheve publicitare.

**Në përgjithësi, këto shtesa janë për t'u përshëndetur. Sidoqoftë, duhet të shtohet edhe një kërkesë në lidhje me shërbimin ndaj minoriteteve në gjuhët e tyre.**

## Neni 14

Neni 25 është ndryshuar për të diferencuar kohëzgjatjen e licensës për shërbimet programore të transmetimit analog dhe numerik (kombëtare ose rajonale/lokale), si vijon:

- Në nivelin kombëtar, një periudhë deri në gjashtë vjet për transmetimin radiofonik analog dhe tetë vjet për transmetimin televiziv analog; dhe për një periudhë deri në 15 vjet për transmetimin radioteleviziv numerik
- Në nivelet rajonale dhe lokale, për një periudhë deri në tre vjet për transmetimin radiofonik dhe pesë vjet për transmetimin televiziv bazuar në teknologjinë tokësore analoge dhe në teknologjinë numerike, dhe për një periudhë deri në shtatë vjet për transmetimet televizive me bazë teknologjinë tokësore numerike.

**Në qoftë se nuk ka gabime në përkthim, neni parashikon dy periudha të ndryshme për kohëzgjatjen e licensave numerike rajonale/lokale. Ky duhet të jetë një gabim dhe duhet të korrigjohet.**

**Gjithashtu, fraza “për një periudhë deri në” përbën motiv për t’u shqetësuar. Kjo duket sikur e lë në të gjykimin e KKRT-së kompetencën për të përcaktuar kohëzgjatjen e licensave, ashtu siç e shikon ajo më të përshtatshme. Kohëzgjatja e licensës ose duhet të jetë e përcaktuar ose ligji duhet të parashikojë kritere të qarta e të justifikueshme për ndryshimin e kohëzgjatjes së licensës.**

Neni rregullon gjithashtu procedurën e rinovimit të licensës. Duket sikur KKRT-ja e ka për detyrim të rinovojë licensën thuajse automatikisht me marrjen e kërkesës, në rast se transmetuesi nuk ka shkelur ligjin.

**Ky rregullim mund të përmirësohet duke u shikuar më tej. Të paktën, KKRT-ja duhet të ketë, gjithashtu, edhe detyrimin për të përcaktuar nëse transmetuesi i ka plotësuar të gjitha detyrimet që përmban licensa.**

## **Neni 16**

Neni 34 është ndryshuar me qëllim marrjen në konsideratë të motiveve të mundshme për heqjen e licensës, si në mjedisin numerik, ashtu edhe në atë analog.

**Në përgjithësi, dispozitat janë të pakundërshtueshme, përjashtojnë paragrafin 6, i cili përcakton motivin e mëposhtëm për heqjen e mundshme të licensës: “ndryshime kanë ndodhur me zotëruesin e licensës, duke e bërë të pamundur përmbushjen e kushteve të përcaktuara në kontratë”. Duke qenë se heqja e një license transmetimi është një masë ekstreme, që duhet të zbatohet vetëm atëherë kur është absolutisht e nevojshme dhe mbi baza plotësisht të justifikuar, vetë ky motiv përbën shkak për t’u shqetësuar. Ai mund të mund të çojë në heqjen e licensës mbi bazën e një gjykimi subjektiv se ndryshimet që prekin transmetuesin mund të mos lejojnë që ai/ajo të zbatojë kushtet e licenses – edhe më parë se diçka e tillë të ndodhë. Kjo**

duhet të riformulohet për të deklaruar se shkeljet e vazhdueshme të termave dhe kushteve të licensës (pavarësisht nga motivet) mund të përbëjnë baza për heqjen e licensës.

**E njëjta gjë vlen edhe për paragrafin 7 “prona e zotëruesit të licensës mund të nxirret në ankand”. Kjo mund të shërbejë, sigurisht, si një tregues që zotëruesi i licensës po kalon vështirësi, por nëse transmetuesi vazhdon të transmetojë programet e përcaktuara në licensë, fakti i vënies në ankand të pronës është i panevojshëm. Ky paragraf duhet të hiqet ose të riformulohet.**

## **Neni 17**

Neni 35 është ndryshuar nëpërmjet shtimit të dispozitave të reja, që iu referohen ndryshimeve që sjell futja e teknologjisë numerike. Pjesa më e madhe e përmbajtjes së re është përshkruese, por tri dispozita janë veçanërisht të rëndësishme:

Paragrafi 7 përcakton raportin e kanaleve të koduara të pakoduara brenda një platforme/multipleks (50%-50%). Paragrafi 8 përcakton raportin e zërave të koduar dhe të jokoduar të programit brenda të njëjtit shërbim programor (30%-70%). Paragrafi 9 përcakton raportin e shërbimeve programore të transmetuara nga operatori i rrjetit (në qoftë se operatori është edhe transmetues) dhe ato të ofruara nga transmetues të tjerë (50%-50%).

**Mbi këto baza, duhet të merret parasysh se transmetimi i 70 për qind të kanaleve duhet të jetë falas, dhe se – në rastet kur operatori i rrjetit është edhe transmetues – të paktën gjysma e numrit të kanaleve në rrjet duhet të jenë të disponueshme për transmetues të tjerë.**

**Përsa i përket çështjes së parë, është për t’u përshëndetur favorizimi i shërbimit të transmetimit të programeve falas, pasi kjo do të ndihmojë nxitjen drejt kalimit në mjedisin numerik. Strategjitë e kalimit bazuar në idenë e shërbimeve me bazë abonimin, kanë rezultuar shumica të pasuksesshme. Shpresojmë që ky vendim bazohet në analizën e tregut, që tregon se transmetuesit do të jenë në gjendje të mbulojnë koston e ofrimit të shërbimeve programore numerike mbi këto baza.**

**Gjithashtu, përshëndetet detyrimi që transmetuesit-operatorë rrjeti të lënë 50% të kapacitetit për transmetuesit e tjerë. Sidoqoftë, kjo nuk e zgjidh problemin e këtyre operatorëve për të refuzuar kanale që mund të konkurrojnë kanalet e tyre. Neni 19/3 (shiko më poshtë) ka për qëllim parandalimin e kësaj, por efektshmëria e tij mbetet për t’u parë.**

**Dispozita që deri më 30% e një shërbimi të hapur programor mund të jetë e koduar, ka nevojë për shikim të mëtejshëm. Shërbimet programore duhet të jenë ose të koduara, ose të pakoduara. Nuk është e qartë se në ç’mënyrë përputhet kjo**

**dispozitë me atë të paragrafit 8. Kodimi i një pjese të shërbimit programor që nga ana tjetër transmetohet ashtu siç është do të krijojë vështirësi shtesë për shikuesit.**

### **Neni 18**

Neni 19/3 shtohet për të rregulluar marrëdhëniet mes operatorëve të rrjetit dhe zotëruesve të licensave për transmetimin e programeve në mënyrën që vijon: *“Operatorët e rrjetit u ofrojnë kapacitete të lira operatorëve të licensuar për transmetimin e programeve radiotelevizive me kushte të barabarta, transparente dhe jodiskriminuese”*.

**Ashtu si theksohet më sipër, kjo është një dispozitë e rëndësishme, por ajo nuk do të ishte e nevojshme nëse operatorët e rrjetit do të përqendroheshin vetëm në atë rol. Nëse nuk ndodh kështu, atëherë duhet të krijohen masa të posaçme paraprake për të shmangur situatat e konfliktit mes transmetuesve konkurrues, disa prej të cilëve janë gjithashtu operatorë rrjeti.**